



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 6016 prot.

Tiranë, më 28/5 / 2019

URDHËR

Nr. 316 datë 28/5 2019

PËR

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 47, DATË 31.03.2016**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b të ligjit Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat",

**URDHËROJ:**

1. Në urdhërin nr. 47, datë 31.3.2016 bëhen këto ndryshime,
  - a. Pas fjalisë së parë të pikës 2, shtohet kjo fjali:  
"Përfshihen nga ky rregull, vetëm për sa i përket telefonave smartphone që mund të kryejnë fotografi, drejtorat e drejtorive, Përgjegjësi i Sektorit të Sallës së Studimit, Përgjegjësi i Sektorit të Promovimit dhe specialisti që kryen kontaktet me mediat i përcaktuar nga Drejtori i Evidencës Qendrore dhe Komunikimit".
  - b. Pas pikës 4., shtohet pika me këtë përmbajtje:  
"Punonjësi i shërbimit të policisë nuk lejon hyrjen e cilitdo punonjës apo vizitor që nuk dorëzon paraprakisht aparatet me mundësi fotografimi dhe çantat në shërbimin e hyrjes. Drejtori i drejtorisë dhe përgjegjësi i sektorit monitorojnë periodikisht zbatimin e këtij urdhëri. Në rast se vërehet se punonjësi gjendet në mjediset e DPA-së me çantë, ose aparat që mundëson fotografi, nis menjëherë procedurën për masë disiplinore."
2. Ngarkohet Sektori i Sekretari-Arkivit ta shpërndajë këtë urdhër te të gjithë punonjësit dhe shërbimin e policisë dhe ngarkohen të gjithë punonjësit për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi më 3 qershor 2019.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Dr. Ardit BIDO

TIRANË